

TËHUAJËSIMI ATIPIK NGA MOTIVI I ATDHEUT

Vjollcë BERISHA¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: vjollca.berisha@unite.edu.mk

Përmbledhje

Ky punim mëton të shtrojë disa teza që shpërfaqin prezencën atipike të motivit të atdheut në letërsinë shqipe të Maqedonisë, e cila letërsi është zhvilluar si pjesë e letërsisë së Kosovës, por që ka zhvilluar edhe tiparet e saja të dallueshme nga pjesa tjetër e letërsisë. Një nga tiparet është edhe qasja e saj ndaj njërës nga motivet më të shpeshta të të gjitha etapave letrare në shkallë të letërsisë kombëtare, siç është motivi i atdheut.

Në këtë punim mëtojmë të paraqesim mënyrën e rrudhjes së këtij motivi, shndërrimin atipik të fjalës vendlindje në një eufemizëm të fjalës atdhe për shkak të rrethanave jashtëletrare që determinonin censurën dhe autosensurën. Përpos shtruarjes së problemeve letrare në formë tezash e mikrotezash, punimi sjell edhe shembuj konkretë, të marrë nga një pjesë e poezisë shqipe të Maqedonisë, që lidhen me hipotezën: se ekziston një tëhuajësim atipik ndaj motivit të atdheut në poezinë e sotme shqipe të Maqedonisë së Veriut, sidomos në atë që u shkrua deri në vitin '90.

Fjalët kyçe: eufemizmi, poezia, tëhuajësimi, kohë, hapësirë, atdhe, vendlindje, lajtmotiv, lirika.

1. Hyrje

Një nga temat e rëndësishme ku konsiston poezia shqipe e Maqedonisë është edhe tema e vendlindjes. Motivin e vendlindjes e hasim në krijimtarinë e të gjithë poetëve shqiptarë të kësaj ane. Ky është një nga motivet më të shpeshta edhe në letërsinë tonë në shkallë kombëtare, por në letërsinë shqipe të Maqedonisë merr disa nuanca të tjera. E para, duke qenë një letërsi e krijuar dhe e kultivuar nën vëzhgimin absolut të sigurimit të shtetit, është e kuptueshme që nocionin atdhe në shumë raste ta gjejmë të alternuar me vendlindjen. Në kërkim të shtigjeve për t'iu larguar motivit të dashurisë ndaj atdheut, i cili motiv vetvetiu lidhte me atdheun si tërësi, jo vetëm në kufijtë e Maqedonisë, poetët e gjejnë zgjidhjen në tëhuajësimin e vargut të tyre ndaj motivit të atdheut, atdhedashurisë, duke e lidhur atë me vendlindjen si një territor i kufizuar në shkallë fshati a qyteti, ku ka lindur individi, poeti a uni lirik i poezisë.

2. Përse ekziston ky tëhuajësim?

E para, populli shqiptar i Maqedonisë së Veriut asnjëherë s' e ka konceptuar si atdhe të vetin Maqedoninë. Me gjithë autoktoninë e pakontestueshme, ata nuk e kanë identifikuar atë tokë me atdheun dhe e tërë kjo për shkak të shtetit që asnjëherë s' ka qenë i tyre, madje ka qenë dhe është armiqësor ndaj shqiptarëve. Ky mosidentifikim i atdheut me shtetin është arsyeja e parë e tëhuajësimit që tregojnë poetët gjatë trajtimit të atdhedashurisë. Arsyeja tjetër është identifikimi i atdheut me Shqipërinë e ndaluar të asaj kohe.

Në një kohë kur merreshë në pyetje, përjashtoheshe nga puna apo e vuaje burgun për shkak se fëmija yt mbante emrin e një lumi a një qyteti në Shqipëri, mund të merret me mend se sa e dënueshme ishte qasja afirmative ndaj këtij shteti dhe sa i ndaluar ishte referimi ndaj këtij vendi si ndaj atdheut. Kështu që, një nga mënyrat më eufemike paraqitet zëvendësimi i fjalës atdhe me fjalën vendlindje. Në këtë mënyrë sqarohet ndoshta shumësia e shfaqjeve të këtij motivi në poezinë e sotme shqipe të Maqedonisë, ku herë trajtohet vendlindja si një hapësirë me të cilën njeriu është ngusht i lidhur për shkak të dashurisë që ka për atë vend ku i ka rënë koka, herë si një topos që e ndjek gjithë jetën poetin ngado që të shkojë, herë si vend i sprovuar në mijëra vuajtje, duke filluar nga skamja e plagët e tjera si kurbeti, braktisja, mendësia provinciale etj., e herë si vatër e kujtimeve, vend ku përjetësisht rron fëmijëria. “Këtë vepër letrare duhet ta njohim dhe ta analizojmë para së gjithash brenda kohës në të cilën është krijuar, në raport me autorin e saj dhe me imperativët përkatës të kohës, sidomos kur kemi të bëjmë me një trevë specifike, një botë brenda hapësirës konkrete”.¹¹¹

Objektet tjera me të cilat jo rrallë identifikohet ky motiv janë edhe shtëpia, me variantet e saj, si kulmi, oxhaku, pragu, sofrë që janë të barabarta me familjen, bashkësinë familjare, dashurinë, me të ndejturit tok etj.¹¹² Kuptimi *shtëpi* zgjerohet në kuptimin hapësirë e kohë. Në domethënien *hapësirë* kur vjen si figura e lagjes, fshatit, vendlindjes e atdheut, si dhe në kuptimin *kohë* kur vjen si emri tjetër i së shkuarës, i ditëve të fëmijërisë. Kundruall këtij zgjerimi kuptimesh e gjejmë edhe zvogëlimin e tij në pjesët përbërëse të shtëpisë. Kur themi për shembull: dera, kulmi, pragu, vatra... e që në mendjen tonë përkthehen në fjalën shtëpi, kullë, qëndresë, mall, mikpritje, fëmijëri, kthim e shumë pjesë të tjera që e ndërtojnë indin e asaj që jemi dhe asaj që kemi. Po ashtu si variante shfaqen edhe: lagjia, arra, fusha, lumi, bregu i liqenit etj.

Me anë të kësaj mënyre të themi të tëhuajësimit ndaj motivit të atdheut, natyrisht vetëm në mënyrë, herë duke aluduar shpeshherë në të, e herë duke krijuar një poezi të pastër që i dedikohet vendlindjes dhe attributeve materiale e shpirtërore të saj, motivi i shpeshtë i atdheut në letërsinë shqipe rrudhet në motiv vendlindjeje që është tepër i dendur në krijimtarinë e shqiptarëve të Maqedonisë, sidomos i poezisë së viteve '70 e '80. Një nga ata poetë që krijojnë përshtypjen sikur nuk do të kishin mundur të krijonin jashtë mjedisit në të cilin jetojnë është edhe Resul Shabani, poezia e të cilit buron nga dashuria për vendlindjen dhe i dedikohet asaj. Duke mos mbaruar këtu, edhe vetë atmosfera poetike ndërtohet po me ndihmën e vendlindjes.

Figurat që përdoren, leksiku poetik gjithashtu janë pjesë e vorbullit të fjalëve që kanë të bëjnë me vendin e tij të lindjes, me liqenin, bregun, ujin, me verën si stina kur vendlindja e tij, duke qenë bjë vend turistik, gjallërohet. Që nga vëllimi i tij i parë me titullin “Peshk”, të botuar në vitin 1975 në Shkup, Resul Shabani paralajmëron një poezi moderne, por që rrënjët i ka thellë në vendlindjen e tij të ujtë. Edhe kur flet për problemet e mëdha të etnisë, si në dy ciklet e para të këtij vëllimi, për shembull, krahasimet e atmosferën i merr nga liqeni i Ohrit, nga ky liqen që ka frymëzuar kaq

¹¹¹ Hasan Mekuli, *Lirikë trajtash e motivesh aktive*, parathënie e veprës “Ngushëllim i bukur” i Murat Isakut, Prishtinë, 1989, f.10.

¹¹² Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997, f.437

shumë poetë shqiptarë, në krye me Lasgushin. Edhe kur flet për historinë e shqiptarëve, për jetën e tyre të vështirë të skalitur në këngë, ai është thellësisht lirik. Gjithçka në poezinë e tij është njësh me natyrën, me stinën kur ajo është lulëzuar: *Në gjuhën e lules janë zbërthyer të gjitha fshehtësitë e botës*. E lashtësia është ajo që e këndon paprajshëm një lahutar plak me instrumentin e tij. Se lahuta për të është e barabartë me këngën, e kënga për shqiptarin rri gjithnjë pranë pushkës. Ky është mesazhi i përhershëm, përkrahimi i përhershëm që ia bën shqiptarit ky poet. Kështu e sheh fatin e vendit të tij, të prirur ndaj këngës, ndaj artit, ndaj së bukurës, por edhe të kushtëzuar nga krisma, nga pushka. Po kështu e ka parë portretin e atdheut edhe poeti tjetër novator Fatos Arapi, i cili në vëllimin *Ritme të hekurta* (1968), në poezinë *Ja, toka ime* thotë:

*Ja toka ime, - e ashpra, e buta
Një krismë pushke.
Pastaj lahuta.*¹¹³

Kështu e ravijëzonin atdheun, historinë e traditën këta dy poetë të ngjashëm për nga mënyra e artikullimit dhe ndjeshmëria poetike, njëri vlonjat e tjetri strugan, ndoshta edhe krejt në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri nëse e marrim parasysh mundësinë e vogël të komunikimit letrar në atë kohë. Kjo mënyrë e vjershërimit dhe e të vënit pranë e pranë të dy gjërave që në shikim të parë jo vetëm s'janë të ngjashme, por edhe e kundërshtojnë njëra-tjetrën, siç është kënga dhe pushka, përtej përkrahimit real e të qëlluar të historisë shqiptare dhe dëshirës për t'i kënduar qoftë lavdesë e qoftë disfatës, është edhe kërkesa e vjershërimit novator.

Është njëri nga postulatet mbi të cilët ngritet stilistikisht poezia jonë novatore e të cilën poeti Ismail Kadare e shpall në veprën e tij “skandaloze” siç e quan ai vetë vëllimin e tij të tretë poetik “Shekulli im”, ku, duke e shpalosur kredon e tij poetike, në një poezi programatike me titull *Poezisë së dekluar*, ku flet zëshëm e me vetëbesim se si duhet të jetë poezia, ç’aftësisht poetike duhet të ketë poeti, e shkruan strofën e njohur:

*Poet është ai që me dorën e fortë
Ashtu siç këput një trëndafil në lëndinë,
Mund të zbërthejë pranë trëndafilin
Edhe një minë.*¹¹⁴

E jo si në poezinë e patosit kolektiv, kur vëmendja më shumë se te bukuria e fjalës përqendrohej në qëllimin, në utilitarizmin e saj. Kur veprohej tamam ashtu siç nuk e duron arti i vërtetë: i kushtohet kujdes asaj që thuhet, e jo mënyrës se si thuhet, pa e pasur parasysh faktin që letërsinë nga biseda e rëndomtë e njerëzve e ndan pikërisht distancimi nga mënyra e zakonshme e shprehjes dhe “mënyra specifike e përdorimit të gjuhës”¹¹⁵

3. Vendlindja si eufemizëm i fjalës atdhe

Pas vëllimit të parë, ku koncepti i vendlindjes është i lidhur edhe me vatrën, me shtëpinë, me familjen, me anëtarët e saj, të cilëve ua kushton nga një poezi, secilit veç e veç, në ciklin e fundit me titull *Intima*. Që nga titulli jep shenjën se ky është cikli i veçantë, intim, që s’ka të bëjë me të përgjithshmen, por megjithatë brenda atyre poezive, përmes të veçantës rend kah e përgjithshme,

¹¹³ Fatos Arapi, *Ritme të hekurta*, Tiranë, 1968, f.4

¹¹⁴ Ismail Kadare, *Shekulli im*, Tiranë, 1961, f. 54

¹¹⁵ Terry Eagleton, *Hyrje në teorinë e letërsisë*, sh.b.”Camaj-Pipa”, Shkodër, 2005, f.10

përmes familjes kah populli, përmes shtëpisë kah vendlindja. E vendlindja në poezinë shqipe të Maqedonisë është shpesh e barabartë me atdheun. Sidomos në atë që shkruhej deri në vitet '90, deri atëherë kur censura që e ashpër dhe dënimet ishin të patejkalueshme për poetin që aludonte në Atdheun shqiptar qoftë me ëndrrën për ta bërë të tërë, qoftë vetëm për atë copë toke që quhej Republika e Shqipërisë e që nuk guxonin t'ia përmendnin emrin, madje as ta kthenin kokën kah ato drita që dukeshin tutje në breg, në Pogradecit me të cilin i ndante një copë ujë.

Ky mall e kjo dëshirë ka qenë i pranishëm në poezinë e shumë poetëve të Maqedonisë, e sidomos atyre që u lindën e u rritën në Strugë, në atë qytet aq afër shtetit mëmë. Në vëllimet e më vonshme koncepti i vendlindjes do të jetë i pranishëm edhe më gjërësisht. Përmes një leksiku të zgjedhur, një artikulimi tërësisht lirik, Resul Shabani do t'i këndojë vendlindjes me gjuhën e huajtur nga ajo vetë, me gjuhën e marrë nga algat nga flora e liqenit, nga valët, zogjtë e peshqit.¹¹⁶

Në vëllimin e botuar me titullin atipik *Oh, Amerika* (1989) ky lajtmotiv i vendlindjes shpërfaqet atëherë kur një lexues jo i informuar mund të priste një udhëpërshkrim klasik, ose ndonjë tekst mallëngjyes a nostalgjik për vendin e mundësive të veçanta. Por, për lexuesin e informuar, për atë që e di se plaga e madhe që identifikohet me mallin, me kurbetin e disa qyteteve të Maqedonisë sidomos, siç është Struga, Dibra, Prespa e Kërçova lidhet pikërisht me Amerikën si diaspora e re e Maqedonisë, drejt së cilës janë zbratur fshatra të tëra. Janë mbyllur shtëpi dhe vazhdojnë të mbyllen.

Sikurse vazhdojnë të lidhen shkesi që do të përfundojnë me martesë që për qëllim kanë daljen, ikjen. Sikurse vazhdon të ëndërrohet për një ikje të këtyrë nga një pjesë tepër e shëndetshme e popullit, siç janë të rinjtë. E tërë kjo s'ka si të mos e shqetësojë botën e ndjeshme të poetit, s'ka si të mos depërtojë në vargjet e tij. Kështu shpjegohet edhe vëllimi me vjersha për kontinentin përtej oqeanit, me një pasthirmë të veçantë, nga më të veçantat që merr nuancë kuptimore kontekstuale, rrethimore, të dhimbjes, hidhërimit a kënaqësisë.

Në letërsinë shqipe është e shpeshtë si pasthirmë, sidomos në poezi, por natyrisht nuk mungon as në prozë. Për shembull, një nga romanet më të bukura të letërsisë moderne shqipe, shkruar nga shkrimtari i rëndësishëm me vizion antitotalitarist Anton Pashku titullohet vetëm *Oh*. Por, në përmbledhjen poetike të Resul Shabanit, kjo pasthirmë ka mallin përbrenda, e më tepër se mallin ka keqardhjen për gjithë atë shpërngulje, ka pengun që s'mund të bëjë asgjë përveçse të këlthasë, ka nyjëtimin e pakënaqësisë me shtetin që jo vetëm se nuk i pengon këto ikje, por edhe i stimulon, ua hap dyert.

E tërë kjo situatë, ky motiv, është brenda makromotivit që është vendlindja e që në krijimtarinë e Resul Shabanit zë bashin e vendit. Edhe përkundër tonit mallkues që dominon në poezitë e këtij vëllimi, sikurse edhe në të gjitha poezitë me motive kurbeti që nga ajo që shfaqet në letërsinë gojore të këtyre anëve e deri te letërsia e shkruar për fëmijë e të rritur, poeti nuk e humb identitetin e unit lirik, e lidh atë më fort me ambientin, që do të thotë se edhe nga largësia e madhe siç është Amerika, ai e lidh me vendlindjen, me rrënjët, duke ia përkujtuar vendlindjen, liqenin, natyrën, peshqit, varkat, lulet, shtëpitë e njerëzit.

Kjo është edhe mënyra përmes së cilës shfaqet me bollëk natyra në poezinë e këtij poeti. Duke ardhur fillimisht si fond, arrin të dalë në plan të parë dhe ta ngërthejë vëmendjen dhe imagjinatën e lexuesit. Ky kurbet që del në këtë vëllim poezish nuk është kurbeti i sotëm i ditëve të internetit, madje edhe telefonatat janë një luks i shtuar, ai është kurbet i një haberi, i një letre që di të vonojë a të mos vijë fare.

¹¹⁶ Floresha Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Tiranë, 2006, f.78

Ardhjen a mosardhjen e një lajmi, poeti lirik i natyrës e krahason po me ndryshimet që ndodhin në qiell a në liqen:

*Nëse nga kurbeti
tre vjet e tri javë
nuk merr letër a fjalë
as me të zeza as me të bardha
je si ekaltër e liqenit natën
kur pikëllimi e bren.¹¹⁷*

Kulti i vendlindjes, i gurit që peshon në vendin e tij, është përherë i pranishëm në poezinë e Resul Shabanit dhe vetëm kaq, ai është një kult që rindërtohet vazhdimisht, duke dhënë edhe këshilla se si duhet vendlindja e cila është domethënia e saj. Ai vendlindjen e përjeton si diçka tepër reale, diçka që duhet shijuar vetëm për së afërmi dhe vetëm duke jetuar në të, prandaj për poetin:

*Vendlindja nuk është vetëm
një kartëpostale¹¹⁸*

Nuk është vetëm një përshëndetje së largu, vendlindja është dashuri, është angazhim, është dëshirë për ta bërë më të mirë e për t'i penguar të tjerët ta braktisin. Insistimi i fuqishëm i këtij poeti për t'i vajtur në epiqendër këtij problemi dhe paraqitja e përhershme e këtij lajtmotivi mund të japë përshtypjen e një lokalizmi motivor, por në të vërtetë bëhet fjalë për një lajtmotiv dialektik, që ndryshon në proporcion të drejtë me vetë jetën, me njeriun dhe rrethanat e jetës së tij. Resul Shabani është një observues i përhershëm i jetës dhe i dukurive që shfaqen njëra pas tjetrës e që secila në vetvete mund të jetë nxitëse ose ngadalësuese e lënies së vendlindjes, apo të rritjes së dashurisë apo apatisë së vendit.

Ligjërimi poetik i Resul Shabanit është i thjeshtë dhe i natyrshëm sikurse temat që trajton, e në veprën *Oh, Amerika* ky ligjërim bëhet edhe më i thjeshtë, hera - herës me nota të lehta humorit, sidomos kur i duhet t'i theksojë ca doke e tentime për shkesi nga përtej oqeani. Ndoshta mu këto tone e kanë ndërruar pasthirmën *Ah* në *Oh*. Pasthirmja *ah* nuk lejon tonin gazmor brenda. Ajo është më tepër sinjal i dhimbjes, i frikës, i mallëngjimit etj., ndërsa *Oh* mund të jetë fare lehtë një pasthirmë qesëndie, humorit, kënaqësie, gëzimi aq sa edhe mallëngjimi, nostalgjie, dhimbjeje, plage të heshtur apo pothuajse të heshtur.

Po ky lajtmotiv vendlindjeje e përshkon tërë krijimtarinë e Resul Shabanit, madje edhe ata libra të pasvitit 2000. Te parathënia e librit *Përsëri për shëlgun lotues*, për shembull, akademik Ali Aliu, duke e dhënë një mendim për librin që sapo botohet (2003) bën edhe përmbledhjen e tërë opusit të Resul Shabanit, ose thënë më mirë të motivit të vendlindjes në këtë opus, pasi kur mendon për poezinë e këtij krijuesi, e para që të bie ndërmend është po ky motiv.

Sipas Ali Aliut, “mund të thuhet se tërë krijimtaria e Resul Shabanit është në lidhje jetike me vendlindjen, me kujtimet e fëmijërisë. Ky ambient, në këtë vepër është shndërruar në një univers-metaforë. Pikat si shtylla orientuese janë: liqeni, lumi (Drini) që buron nga thellësitë e malit të Thatë dhe Kalishti – fshati buzë gjolit, i poetit... Matrica bosht prej ku rrezaton pluskimi i ngacmimeve, i ngjalljes dhe i ringjalljes së botës virgjërisht të jetuar dhe të ëndërruar, është gjoli....

¹¹⁷ Resul Shabani, *Oh, Amerika*, Rilindja, 1989, f.7

¹¹⁸ Po aty, f.17.

Në këtë etje poetike, me aromë ngrohtësie të jugut, shija e parë është malli, malli i pangushëllueshëm e që në çaste kalon në pikëllim.¹¹⁹ Ky mall, tejet i dukshëm, sidomos në veprat e tij të fundit ka të bëjë me ndalesën për t'u kthyer në të shkuarën, për t'u kthyer në fëmijëri. Edhe ky gjakim universal i njeriut, i dëshirës së tij për ta kthyer mbrapsht kohën, te ky poet vjen me vulën e veçantë të tij që ka të bëjë me vendlindjen. Dëshira dhe mallëngjimi i kthimit bëhet, të paktën deklarativisht, për t'u kthyer në vendlindjen e dikurshme që s'është kjo e sotmja, tek ata njerëz të asaj kohe, tek ajo natyrë e tek ai qiell që më s'është i njëjti.

Një mënyrë tjetër e artikulimit të poezisë së vendlindjes, po që kësaj here ka të bëjë me Sharrin, me jetën e vështirë të malësorit shqiptar, i cili mezi ekzistonte, i cili ishte si të thuash i lënë tërësisht jashtë sistemit të shtetit haset në poezinë e një sërë poetëve nga Maqedonia, duke filluar nga Murat Isaku, Abdylazis Islami, për poezitë e të cilëve kemi folur në kapitujt paraprakë, e deri te disa poetë që ndonëse me moshë i takojnë brezit të mesëm, të lindur në vitet '40, vëllimet e para poetike i kanë botuar pas vitit '90.

Megjithëkëtë fakt, poezia e tyre është më tepër vazhdimësi e pozisë që krijonte brezi i tyre biologjik, sesa ai që do të fillojë të shkruajë një gjeneratë e re e poezisë, që dallojnë mjaft për nga artikulimi nga brezi paraprak. Të tillë ishin poetët Ramadan Sinani, Ibrahim Veliu, Fadil Bekteshi etj., të cilët për arsye të ndryshme objektive arritën t'i botonin vonë vëllimet e tyre të para poetike, ndonëse ishin mjaft aktivë në jetën letrare të kohës, në botime nëpër gazetatat dhe revistat letrare që dilnin asokohe.

4. Përfundim

Ndoshta një nga temat më interesante që lidhen me letërsinë e Maqedonisë ka të bëjë me artikulimin e motiveve të veçanta. Ky punim pati për qëllim që të veçonte një prej tyre dhe ta vërtetonte tezën se në të shumtën e rasteve në poezinë e sotme që krijohet në Maqedoni fjala vendlindje është ekuivalente me atdheun. Kjo ndodhte sidomos deri në vitin '90 për shkak të rrethanave specifike jashtëletrare. Punimi mëton t'i sintetizojë disa nga arsyet që ndikojnë për këtë rrudhje semantike dhe t'i përjasë ato me shfaqje të ngjashme në pjesën tjetër të letërsisë kombëtare. Mund të përfundohet se ky tëhuajësim ndodh për shkak një sërë rrethanash që i kemi radhitur më sipër dhe që s'kanë të bëjnë me ligjësitë letrare dhe është tipik për poezinë e Maqedonisë.

Referencat

- [1]. Ali Aliu, parathënia e librit *Përsëri për shëlgun vajtues*, Onufri, Tiranë, 2003.
- [2]. Floresha Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Tiranë, 2006.
- [3]. Fatos Arapi, *Ritme të hekurta*, Tiranë, 1968.
- [4]. Ismail Kadare, *Shekulli im*, Tiranë, 1961.
- [5]. Hasan Mekuli, *Lirikë trajtash e motivesh aktive*, parathënie e veprës "Ngushëllim i bukur" i Murat Isakut, Prishtinë, 1989.
- [6]. Resul Shabani, *Oh, Amerika*, Rilindja, 1989.
- [7]. Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997.
- [8]. Terry Eagleton, *Hyrje në teorinë e letërsisë*, sh.b."Camaj-Pipa", Shkodër, 2005.

¹¹⁹ Ali Aliu, parathënia e librit *Përsëri për shëlgun vajtues*, Onufri, Tiranë, 2003, f. 5-6